



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. 562 Prot

Datë 02/08/2022

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 shpall 1 vend vakant për pozicionin e punës: **As/Dirigjent (Inspektor Skene) pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë.**

Kandidatët për pozicionin e punës duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

As/Dirigjent(Inspektor Skene) pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:

1. Të ketë kryer studimet e larta në degën e muzikës (bachelor ose master) ose diplomën ekuivalente me to;
2. Diplomë e përfundimit të shkollës dhe listë notash të noterizuara;
3. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
4. CV bashkangjitur me Foto;
5. Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet. Preferohen kandidatët me përvojë në Institucione Teatrore;
6. Të ketë aftësi të mira komunikimi - ndërpersonale, të shkruara dhe verbale;
7. Të ketë aftësi të organizojë punën duke përmbushur afatet;
8. Të ketë aftësi të drejtojë punën me efikasitet, efektivitet dhe transparencë.
9. Të ketë njohuri të gjuhës angleze.
10. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike;

Përgjegjësitë/Detyrat Kryesore;

1. Kontrollon përpara çdo prove në skenë impiantin skenik në mënyrë që ai të jetë gati për provat sipas kërkesave të regjizorit, balet maestrin etj.
2. Planifikon oraret e stafit artistik në bashkëpunim me Drejtuesin e Drejtorisë Artistike të Operas dhe Filarmonisë.
3. Koordinon punën e drejtorisë artistike dhe asaj teknike duke u bërë pjesë aktive e caktimit të orareve të punës në skenë në bashkëpunim me drejtorin artistik, teknik, regjizor dhe balet maestr.
4. Koordinon hyrjen në skenë të korit dhe të solistëve gjithashtu merr përsipër të ndërtojë formacionin e orkestrës për prova shfaqje ose koncerte në sallën e orkestrës, në gropën e orkestrës, në skenë si dhe në aktivitete jashtë teatrit.
5. Njofton të gjithë pjesëmarrësit në prova apo shfaqje për oraret e vendosura ose për ndryshimet e tyre eventuale si dhe ndjek montimin dhe cmontimin e skenave.
6. Merr masat e duhura që teknika skenike të jetë në gadishmëri për çdo lëvizje skenash gjatë provave. Merr përsipër angazhimin duke shënuar në partiturë sipas kërkesave të regjizorit ose baletmaestrin hyrjen e solistëve në skenë, hyrjen e korit, lëvizjet e dekorit, numrat e efekteve të ndriçimit duke dhënë teknikës momentet muzikore të lëvizjeve që kryhen gjatë shfaqjes.
7. Kontrollon gadishmërinë e garderobës, vendosjen e orkestrës, ndriçimin, foninë etj dhe pasi konfirmon që çdo gjë është në rregull lajmëron dirigjentin për fillimin e shfaqjes.
8. Ndjek shfaqjen me partiturë duke filluar që nga hapja e siparit deri në përsëritjen e fundit.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

1. Jetëshkrimi CV;
2. Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara.
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP(zyra e protokollit) ose të skanuara në mailin zyrtar të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri me datë 24/08/2022. Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara do të lajmërohen nepërmjet numrit të tyre të kontaktit ose mail nga Sekretaria e Institucionit, për intervistën e strukturuar me gojë.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të web-it të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor www.tkob.gov.al; faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

DREJTORE e PËRGJITHSHME

Abigeila VËSHITINA

Konceptoi Juriste Migona Bina

